



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Spektori i Monitorimit të Infrastrukturës Kritike dhe Teknologjive të reja

Nr. 978 Prot.

Tiranë, më 25. 03 2026

Lënda: Programi vjetor i aktivitetit të sektorit për periudhën mars – dhjetor 2026 i veprimtarisë së Monitorimit të Infrastrukturës Kritike dhe Teknologjive të reja

Drejtuar: Bordit të ERE-s
Për Dijeni: Sekretarit të Përgjithshëm
Z. Elton B Radheshi

Të nderuar,

Në mbështetje të detyrimit të parashikuar në nenin 12, pika 2 të Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020, i ndryshuar, i cili përcakton se: “Drejtoritë do të përgatisin për Bordin programin vjetor të aktivitetit për vitin pasardhës, kopje e të cilit i vihet në dispozicion Sekretarit të Përgjithshëm. Sekretari i Përgjithshëm do të bejë me dije anëtarët e Bordit mbi qëndrimin e tij mbi sa planifikuar. Kopje e qëndrimit të Sekretarit të Përgjithshëm i bëhet me dije edhe drejtorive/njësive organizative”. Në vijim të vendimarrjes së Bordit të ERE-s Nr. 21 datë 27.01.2026 mbi “Miratimin e Strukturës, Organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës së Entit Rregullator të Energjisë (ERE)”, Spektori i Monitorimit të Infrastrukturës Kritike dhe Teknologjive të reja, i cili sipas lidhjes 2 të Vendimit sipërcituar përbëhet nga stafi, kategoria e mesme drejtuese dhe kategoria ekzekutive, me funksionet si më poshtë:

Përgjegjës Spektori (1) drejton dhe koordinon veprimtarinë e sektorit, duke siguruar administrimin efektiv dhe ndjekjen e çështjeve që lidhen me infrastrukturën kritike të sigurisë kibernetike dhe impaktin e teknologjive të reja.

Planifikon, organizon dhe mbikëqyr aktivitetin e sektorit. Koordinon masat për mbrojtjen e sistemeve dhe të dhënave nga rreziqet kibernetike. Ndjek politikën dhe standardet për infrastrukturën kritike në sektorin e energjisë dhe zbatimin e tyre nga operatorët e infrastrukturave kritike në sektorin e energjisë. Bashkëpunon me struktura të brendshme dhe institucione përgjegjëse për sigurinë kibernetike. Raporton periodikisht tek drejtuesit e institucionit për çështjet e sigurisë kibernetike të infrastrukturave kritike dhe teknologjive të reja.

Specialist (2), mbështet sektorin në aspektin ligjor dhe rregullator, duke ndjekur çështjet që lidhen me infrastrukturën kritike, teknologjinë e informacionit, sigurinë kibernetike dhe mbrojtjen e të dhënave. Ndjek dhe analizon kuadrin ligjor dhe rregullator në fushën e infrastrukturave kritike. Mbështet përgatitjen e akteve, procedurave dhe marrëveshjeve në fushën përkatëse. Bashkëpunon me strukturat e tjera për trajtimin e çështjeve që lidhen me sigurinë kibernetike.

Monitorimi i Operatorëve të Infrastrukturave Kritike dhe të rëndësishme të informacionit

- Ndjekja e raportimeve 6 mujore të operatorëve që administrojnë infrastruktura kritike në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror.
- Monitorimi i zbatimit të masave të duhura teknike dhe organizative nga operatorët e licencuar sipas detyrimeve ligjore.
- Monitorimi në përmbushjen e kërkesave në implementimin e standardeve ndërkombëtare të sigurisë kibernetike (Çertifikimi ISO 27001).
- Kryerja e vizitave monitoruese (inspektimeve), nëse do jetë e nevojshme, për të verifikuar integritetin e infrastrukturave kritike.
- Bashkëpunimi me institucionet kombëtare të sigurisë kibernetike (si Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike) për raportimin e incidenteve, nëse do jetë e nevojshme.

Teknologjitë e Reja dhe Digjitalizimi

- Analizimi i planeve të investimeve të operatorëve lidhur me implementimin e rrjeteve inteligjente (**smart grids**).

Kuadri Ligjor

- Përgatitja e raportit vjetor mbi gjendjen e infrastrukturave kritike dhe sigurisë teknologjike të OIKI ku do detajohet gjendja aktuale e Sigurisë Kibernetike për Operatorët.

Bashkëpunimi dhe Trajnimi

- Organizimi i seancave dëgjimore, nëse do jenë të nevojshme, me operatorët për të diskutuar statusin aktual, si dhe sfidat kundër rreziqeve kibernetike.
- Pjesëmarrja në grupet e punës ndërinstitucionale për politikën kombëtare të sigurisë kibernetike.

Përgatiti:
Elvis Toska



Miratoi:
Elton B Radheshi
Sekretar i Pergjithshëm